

UDHËZIM
Nr. 13, datë 8.3.2018

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË,
VITI SHKOLLOR 2017-2018**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 26.4.2017, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2013, “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2017-2018, do të zhvillohen si më poshtë:
 - a) Lënda Gjuhë e huaj, më 11 qershor 2018.
 - b) Lënda Gjuhë shqipe, më 18 qershor 2018.
 - c) Lënda Matematikë, më 22 qershor 2018.
2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare do të zhvillohet më 15 qershor 2018.
3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës/ve të huaj/a hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.
4. Nxënësit e klasave IX parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze janë të lirë të zgjedhin midis gjuhës së huaj të parë, që kanë filluar në klasën III, dhe gjuhës së huaj të seksionit përkatës, të filluar në klasën VI.
5. Testi i gjuhës së huaj për nxënësit e klasave IX parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze të hartohet dhe të korrigjohet në bashkëpunim me mësuesit e huaj dhe shqiptarë të këtyre seksioneve.
6. Provimet kombëtare të arsimit bazë fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
7. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për “Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017-2018”.
8. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Në ditën e provimit, Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë tërheqin tezen në DAR Gjirokastrë.
9. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
10. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
11. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë, “Ramazan Kabashi”, drejtorja e institutit tërheq testin nga QSHA-ja një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *brail*.
12. Nxënësi mbetet në provimet kombëtare të arsimit bazë ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
13. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
14. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR /ZA-ve, në Qendrat e Vlerësimit të Testeve.
15. Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës i DAR/ZA-së merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, ISHA dhe MASR.

16. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyra Arsimore dhe institucionet shkollore. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla